



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 70/2 prot.

Tiranë, më 14. 02. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 29, datë 14. 02. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*<sup>1</sup>”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 12 Regj., datë 17.01.2023, të shtetasit D. M., kundër Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Bordit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë me pretendimin e diskriminimit për “*shkak të etnisë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, vendbanimit, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*”<sup>3</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues ka shpjeguar se referuar në urdhrin nr. 5053/4, datë 28.06.2006 të Ministrisë së Drejtësisë, është pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të Noterit. Nga momenti i regjistrimit në organet përkatëse, konform legjislacionit në fuqi, ankuesi ka ushtruar profesionin e Noterit pa ndërprerje. Gjatë ushtrimit të profesionit, prej rreth 16 vite, ankuesi pretendon se ndaj tij nuk është marrë asnjë masë disiplinore, duke kryer detyrën e tij me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Sipas e-mailit të subjektit ankues më datë 01.02.2023, sqaron se:

- Përkatësia etnike “Gege”, lidhet me tiparet kulturore dhe tradicionale Dibrane...;
- Përkatësia në një grup të veçantë- perceptimi potencial i diskriminuesit si veçori e supozuar...;
- Bindjeve politike- ideologjisë politike...;
- Gjendjes ekonomike dhe sociale - Mospasjen e kushteve minimale të jetesës për të ushtruar profesionin e noterit në Dibër...;
- Gjendja shoqërore- Kushtëzohet nga prejardhja dhe gjendja ime shoqërore. Origjina e prejardhjes nga Veriu (Dibra), pengesë për transferimin e vendit të ushtrimit të profesionit të noterit në Tiranë.
- Vendbanimi- për arsye të kërkesës për transferim të selisë noteriale nga Rrethi Gjyqësor Dibër në Rrethin Gjyqësor Tiranë, ku ankuesi ka vendbanimin...;

Gjatë periudhës së pandemisë, ankuesi thekson se ai së bashku me familjen, janë prekur nga Covid-19 dhe pjesën më të madhe të kohës i është dashur ta kalojë pranë familjarëve, të cilët për arsye shëndetësore trajtoheshin pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Në këtë periudhë kohore, shtetasi G. S., ka paraqitur ankim pranë Ministrisë së Drejtësisë kundër subjektit ankues. Referuar këtij ankimi, Ministria e Drejtësisë me Urdhrat nr. 50, datë 13.02.2019 dhe nr. 50/1, datë 05.04.2019, ka urdhëruar kryerjen e hetimit të posaçëm administrativ për ankuesin. Sipas ankuesit, në përfundim të hetimit, nga ana e grupit të inspektimit është mbajtur një raport fiktiv, duke propozuar heqjen e licencës së noterit për ankuesin.

Si pasojë e pamundësisë fizike dhe shëndetësore, ankuesi thekson se ka transferuar zyrën e tij noteriale në një adresë tjetër brenda territorit të rrethit Dibër, pranë zyrës së mëparshme, në pronësi të familjarëve të tij. Në pamundësi për të bërë me dije inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë për këtë veprim, nga ana e tyre është pretenduar se ankuesi nuk disponon zyrë në rrethin e Dibrës dhe për këtë arsye kanë rekomanduar fillimin e inspektimit të përgjithshëm.

Në vijim, sipas ankuesit, edhe pse procedimi disiplinor ishte parashkruar, Ministria e Drejtësisë, me Urdhrin nr. 370, datë 09.11.2020, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të përgjithshëm ndaj tij. Inspektimi ka vijuar edhe pas muajit Mars 2020, kur është kontaktuar nga inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë, të cilët i ka bërë me dije se për arsye shëndetësore të familjarëve të tij ndodhet pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Në një moment të dytë, ankuesi sqaron se i ka pritur inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë në zyrën e tij, të cilët kanë zhvilluar kontrollin dhe kanë dalë në përfundimin se ajo i përmbush kushtet minimale për ushtrimin e profesionit të noterit.

Pavarësisht inspektimeve të kryera, Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 91, datë 23.02.2021, ka urdhëruar nisjen e procedimit disiplinor, ndërkohë që ai kishte nisur më parë me urdhrat e sipërcituara. Në vijim, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, ankuesi është vënë në dijeni të raportit, sa i përket kryerjes së kontrollit në zyrën e tij nga inspektorët e ngarkuar. Pasi është njohur me përmbajtjen e raportit, ankuesi pretendon se nënshkrimi i njërit prej inspektorëve në këtë dokument, nuk ishte i njëjtë me ato të vendosura në procesverbalet e mbajtura më parë gjatë kontrolleve të ushtruara në zyrën e tij. Për këtë shkak, ankuesi i është drejtuar me kallëzim penal Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka filluar procedimin penal për veprën penale të falsifikimit të dokumentave.

Përsa më sipër, ankuesi i ka kërkuar Bordit Disiplinor pezullimin e shqyrtimit të raportit të pretenduar si të falsifikuar deri në përfundim të çështjes penale të filluar. Pavarësisht kërkesës së ankuesit, Bordi Disiplinor referuar raportit në fjalë, me vendimin nr. 4/2021, datë 26.05.2021, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës të Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj noterit D. M.;*

- *Lënien në fuqi të masës disiplinore të propozuar nga Ministri i Drejtësisë sipas nenit 26, pika 2, germa dh, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”;*
- *Heqjen përfundimtare të licencës së ushtrimit të profesionit të noterit D. M.;*
- *Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhërit përkatës për zbatimin e këtij vendimi;*
- *Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë për publikimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij, në regjistrin e masave disiplinore në zbatim të neneve 54 dhe 55 të ligjit 110/2018 “Për noterinë”.*

Në lidhje me vendimmarrjen e sipërcituar, ankuesi i është drejtuar ish Ministres së Drejtësisë me Note Proteste, duke i bërë të ditur se veprimet e tyre janë diskriminuese, arbitrare dhe plotësisht të paligjshme, që nuk kanë aspak lidhje me punën e tij dhe shkojnë përtej profesionit.

Gjithashtu, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në ankimin me objekt:

- *Shfuqizimin e Vendimit nr. 4/2021, datë 26.05.2021 të Bordit Disiplinor, pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, “Për dhënie mase disiplinore ndaj noterit D. M.”;*
- *Kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme;*
- *Fshirjen e çdo regjistrimi të kryer në Regjistrin e Noterëve, pranë Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me këtë vendim;*
- *Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile;*

Përsa më sipër ankuesi pretendon se nga ana e gjyqtarit të çështjes është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë, në shkelje të legjislacionit duke vendosur në bazë të dokumentave të falsifikuara. Për këtë, ndaj gjyqtarit ankuesi i është drejtuar me ankim Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë dhe organeve të Vetingut. Gjithashtu, referuar informacionit të vënë në dispozicion, ankuesi më datë 25.11.2021, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, duke kërkuar ndryshimin e Vendimit nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në këtë kontekst, ankuesi ka pretenduar se për shkak të *etnisë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, vendbanimit, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*, kundrejt tij janë ndërmarrë veprime diskriminuese, duke i hequr licencën e ushtrimit të profesionit të noterit.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit ndaj tij dhe marrjen e masave për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur duke rikthyer atë në gjendjen e mëparshme të profesionit të noterit, si dhe duke caktuar një afat për kryerjen e tyre.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përgjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në informacionin e dërguar me anë të e-mail-it datë 07.02.2023, subjekti ankues ka bashkëlidhur dhe kopje të dokumentacionit poshtëcitur:

- Ankim kundër Vendimit nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ, regjistruar më datë 25.11.2021, me objekt: *“Ndryshimin e vendimit nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur pranimin e kërkesë padisë”*.

Ankuesi në kërkesë padinë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në objekt të ankimit ka kërkuar:

- *Shfuqizimin e Vendimit nr. 4/2021, datë 26.05.2021 të Bordit Disiplinor, pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, “Për dhënie mase disiplinore ndaj noterit D. M.”;*
- *Kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme;*
- *Fshirjen e çdo regjistrimi të kryer në Regjistrin e Noterëve, pranë Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me këtë vendim;*
- *Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile;*

Në parashtrimet e tij në kërkesë paditë e paraqitura (pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Apelit) dhe pranë Komisionerit, ankuesi në mes të tjerash ka kërkuar shfuqizimin e Vendimit nr. 4/2021, datë 26.05.2021 të Bordit Disiplinor dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme.

Gjithashtu, në parashtrimet e tij në kërkesë paditë e paraqitura (pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Apelit), ka parashtruar ndër të tjera se nga ana e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankim, përmes veprimeve dhe mosveprimeve: “... është shkelur Neni 17, i Kodit të Procedurës Administrative “Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit”, i cili parashikon: Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ku trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër...”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-paditë e ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, të depozituar si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, për diskriminim, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë”.

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

*“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 12 Regj., datë 17.01.2023, të shtetasit D. M., dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj<sup>4</sup>.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, Komisioneri për Mbrojtjen

<sup>4</sup> Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 129, datë 28.06.2022 të Komisionerit.

nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë<sup>5</sup>, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 12 Regj., datë 17.01.2023, të paraqitur nga shtetasi D. M., për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: etnia, bindja politike, gjendja ekonomike, gjendja shoqërore, vendbanimi, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër.

Fusha: Punësim

---

<sup>5</sup> Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.